




HAMZA KOÇIU

köngë  
pör delin

HAMZA KOÇIU

KËNGË  
PËR DETIN

- VJERSHA -



~~40656~~  
13121

Tiranë 1960 vjetë - Shkolla e mesme - Liceul nr. 1010/25  
SHTEPIA BOTONJSE «NAIM FRASHERI»  
SPGD NISB. SPALABEGJETESIA «PRILIPET DHE — JUANG 1960

HAWA KODIN

KENGË

PËR DETIN

- MERSHA -

1500  
Tirazhi  
kopje  
Shtypshkronjave  
«Mihal Duri» — Tirana, 1967

Tirazhi 1500 kopje      Format 70x100/32      Stash. 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tirana, 1967

## ATDHEU IM

Atdheu im.

Ky shtrati stërgjyshor

Plot plagë mori në brinj' e kraharor,  
Por nuk u dha, qëndroi në çdo murlan  
Si karakoll vigan.

Atdheu im.

Kjo tok' e amëshuar

Shkëlqen, gjithnjë si yll i zjarrtë,  
Stolira ka në gush' e kraharuar;  
Thesare ka një fushë të pamatë.

Atdheun tim, këtë të shtrenjtin vis,

Një çap i ngusht' nga armiqt' e tij e ndan,  
Por i sigurt, drejt rrugës s'tij lëviz,  
Se kazm' e pushkë në duar fort i mban!

## KËNGA IME

### I

Mbi një rrugë më lindi nëna ime  
Dhe, që atëhere, rrodhën shumë vjet,  
Tashti i qeshur unë mbledh kujtimet  
Dhe çaj si rrnymë rrugën nëpër det.

### II

Jam ëndërrtar i ditëve të bardha,  
Këngën si çajkë e përcjell larg  
E, nëse thirra: «Shokë, shpejt, u zbardha!»  
Lotë trishtimi nuk derdha në varg.

### III

Nuk më pëlqen në vjershë fjal' e madhe.  
Si deti më ngjan vargu kur gjëmon.  
Më prekin lulet, bari ndër livadhe,  
Mali me borë, lumi që vërshon.

## IV

Dua të eci me hap më të shpejtë  
Mbi vendin tim që quhet Shqipëri,  
Në majë malesh të puthem me retë  
E të thërrres: «Ja, gjeta poezi»!

## V

Në breg i mblojha këngët, si thërrimet,  
Në detin-hekur ato morën krah  
dhe si detarët rendin ndër lundrime,  
Elikën<sup>1)</sup> këmbë, shpirt i tyre ka.

---

1) Elikë — mekanizëm me fletë që vë në lëvizje anien.

TI TË JESH ME MUA NJË USHTARE

Pranë dua të të kem pérherë  
 Jo këtu ku bëjmë brromp me birrë,  
 Por kur er' e luftësë të bjerë,  
 Ti të jesh' shenjusja më e mirë.

Dhe kur dita si natë të nxijë,  
 Ti të jesh' me mua një ushtare,  
 Jo të përkëdhelesh si fëmijë,  
 Por mbi hasmin të shkrehësh batare.

Mos guxo të hedhësh një hap prapa,  
 Se të vras, të quaj dezertore,  
 Dhe nuk dua të thuash: «E ngrata,  
 Qenka fati të vdes në llogore.»

Sikur predh' e hasmit njëzet herë  
 Të m'i presë krahët, prapseprapë  
 Do qëndroj si lisi degëprerë,  
 Dhe me dhëmbë pushkën do ta kap.

Veç në më qëlloft' ai në ballë  
 Ti në zemër ta qëllosh atë,  
 Ta qëllosh dhe mos e shuaj mallë  
 As me lot të hidhur, as me gjë.

Eja rendim nëpër malet, pyjet,  
Ti ushtare dhe unë ushtar.  
Le të zgjaten udhët gjer te yjet,  
Kur ne mbrojmë trollin shqiptar.

Le të flejmë netve-ftohtësirë  
Si dy zogj nënë kaçube;  
Le të ecim rrugës së vështirë,  
Republika roje na ka ne.

## LUNDRIM TË MBARË!

U dha alarm:  
«Anijen gati për lundrim!»  
Merr raport  
    Shoku oficer  
Dhe urdhër jep.  
Anija shkon drejt detit që shkëlqen,  
Dhe pas' e la të artin breg.  
Ja, në direk,  
Krenar valon  
Flamur' i komandantit tonë.  
Detarët gati rrinë për luftim,  
Me zjarr e flakë  
Armiqt' do t'i djegin me tërbim  
Mes detit të shkumëzuar që perçet, shkund.

Alarm u dha:  
Sinjale, tingllime të pafund  
Dhe, në atë çast, shoku komandant  
Detarët përgëzon,  
Anija dallgët çan  
Dhe pas e la  
Të kaltërin liman.  
Anija detin çan me pash.

Ja, përmbi bash,  
Nga lart e kryet var,  
Ky dielli rrezear  
Kurse i liri, i yni breg  
Me mall e përshtëndet:  
«Lundrim të mbar', anije, nëpër det!»